



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova-Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada – Government**

---

Rregullore e Punës së Kuvendit Komunal të Kllokotit- Vërbocit

---

**02. Shkurt 2010**

---

# Rregullore e Punës së Kuvendit Komunal të Kllokotit- Vërbocit

---

02.Shkurt 2010

Në pajtim me nën-nenet 2 (b) dhe 4 (b) të nenit 4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Nr.03/L-0140) Kuvendi Komunal i Komunës së Kllokotit – Vërbocit, në seancën e mbajtur më 02.02.2010, miratoi këtë Rregullore të Punës:

## Neni 1

- 1.1 Rregullorja e punës përcakton detyrat dhe mënyrën e funksionimit të kuvendit komunal të komunës.
- 1.2 Kjo rregullore e punës do të aplikohet edhe për komitetet e kuvendit komunal *mutatis mutandis*.

## Neni 2

Në këtë rregullore të punës, termet më poshtë do të kenë kuptimin si në vijim:

**“Komunë”** nënkuption komunën e Kllokotit-Vërbocit.

**“Sekretariati i Kuvendit”** nënkuption shërbimet relevante që i ofrojnë ndihmë kuvendit komunal dhe organeve të tij.

**“Çështje urgjente”** nënkuption një çështje që ka të bëjë me situatë vërtetë emergjente për të cilën kuvendi duhet të vendsoë dhe e cila nuk mund të trajtohet në kuvend brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

**“Fjalët dhe veprimet fyeze”** nënkuption fjalët e folura apo të shkruara që përdoren në kuvendin komunal apo në komitetet e tij dhe të cilat:

- a) Janë fyeze apo kërcënuese,
- b) Janë sulme personale apo ofendime,
- c) Nuk janë në gjuhë parlamentare,
- d) Nxisin dhunë,
- e) Nxisin dhunë gjinore,
- f) Akuzat e drejtpërdrejta kundër çdo anëtarë të kuvendit komuanl apo drejtori të drejtorisë.

**“Grupi parlementar”** nënkuption një grup prej tre o më shumë anëtarëve të një partie, koalicioni apo iniciative të qytetarëve të cilët janë anëtarë të kuvendit dhe të cilët e kanë informuar kryesuesin e kuvendit komunal për qëllimin e tyre për të vepruar si grup parlamentar.

**“Java e punës”** nënkupton javën e punës gjatë së cilës kuvendi komunal mban seancë, përvçe javës kur kuvendi mblidhet gjatë ditëve jo të punës për të diskutuar çështje urgjente.

**“Dita e punës”** do të thotë dita e javës nga e hëna deri të premten, duke përjashtuar pushimet publike, gjatë javës kur kuvendi normalisht takohet.

### Neni 3

#### Mbledhja inauguruese e kuvendit komunal

3.1 Kuvendi i komunës e mban mbledhjen inauguruese brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

3.2 Mbledhja inauguruese e kuvendit të komunës thirret nga kryetari brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendor i Zgjedhjeve.

3.3 Nëse kryesuesi i kuvendit të komunës nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës në paragrafin 2 të këtij nenit, mbledhja inauguruese e kuvendit të komunës mund të thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i kuvedit komunal, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kryetari është dashur të thirrë mbledhjen inauguruese të kuvendit të komunës.

3.4 Nëse anëtari më i vjetër i kuvedit nuk e thërret mbledhjen sipas detyrës së tij në paragrafin 3 të këtij neni, mbledhja inauguruese e kuvendit të komunës mund të caktohet me iniciativë të shumicës së anëtarëve të zgjedhur të kuvendit të komunës;

3.5 Mbledhjet e kuvedit të komunës që mbahen para zgjedhjes së kryesuesit të kuvedit të komunës kryesohej nga anëtari më i mosuar i kuvedit të komunës që është i pranishëm në mbledhje.

3.6 Kryesuei i seancës së kuvedit komunal fton kryeatarin dhe anëtarët e tjera të kuvedit për ta nënshkruar betimin apo deklaratën e mandatit.

3.7 Kryetari i komunës nënshkruan betimin solemn si vijon: "Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjt detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si kryetar i komunës së Kllokotit – Vërbopcit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë". Teksti i betimit për kryetarin lexohet nga kryesuesi, ndërsa kryetari bën betimin me fjalën "Betohem". Pastaj kryetari nënshkruan betimin.

3.8 Kryetari i cili nuk jep betimin apo nuk e nënshkruan atë brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve pushon së qeni kryetar.

3.9 Të gjithë anëtarët e kuvedit të komunës duhet ta nënshkruajnë betimin solemn apo deklaratën, si në vijim:

"Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjt detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvedit të komunës së Kllokotit-Vërbocit në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë". Teksti i betimit për anëtarët e kuvedit komunal do të lexohet nga kryesuesi, ndërsa anëtarët duke e dhënë betimin me fjalët "betohem". Në këtë rast çdo anëtar nënshkruan betimin.

3.10 Anëtarët e kuvedit të komunës, të cilët nuk e bëjnë apo nuk e nënshkruajnë betimin brenda një muaji pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve, pushojnë së qeni anëtarë.

### Neni 4

#### Mbledhjet e rregullta të kuvedit komunal

- 4.1 Kryesuesi i kuvendit komunal thërret dhe kryeson mbledhjete kuvendit komunal dhe në mungesë të tij mbledhjet i thërret dhe I kryeson zëvendëskryesuesi për komunitete.
- 4.2 Në mungesë të kryesuesit të kuvendit komunal dhe të zëvendëskryesuesit për komunitete, mbledhjet e kuvendit thirren nga një e katërt e anëtarëve të kuvendit dhe kryesohen nga anëtarë më i vjetër i kuvendit.
- 4.3 Mbledhjet e kuvendit gjithashtu mund të thirren me kërkesë të çdo komiteti të kuvendit.
- 4.4 Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të thirren nga kryesuesi apo zëvendësi/sja i/e tij me kërkesë me shkrim të 1/3 së anëtarëve të kuvendit komunal, apo me kërkesë të kryetarit të komunës.
- 4.5 Nëse nuk vendoeset ndryshe me shumicën e kuvendit komunal, mbledhja e kuvendit komunal mbahet na sallën e kuvendit të komunës në adresën ( duhet të shkruhet adresa e saktë pasi që të dihet)
- 4.6 Mmbledhjet e kuvendit komunal dhe komitetet e tij mbahen, së paku, dhjetë herë brenda nji viti kalendarik me mundësi të mbajtjes së më shumë seancave, nëse kërkohen, pesë prej të cilave duhet të mbahen në gjashtë muajt e parë.
- 4.7 Kuvendi dhe komitetet e tij mbajnë mbledhje të regullta, jashtëzakonshme dhe solemne në përputhje me statutin, rregulloren aktuale të punës dhe regulloreve të tjera të komunës.
- 4.8 Kryesuesi/sja, apo në mungesë të tij/saj zëvendësi/saj informojnë anëtarët e kuvendit së paku shtatë ditë pune para çdo mbledhje të regullt, apo tri ditë pune para çdo mbledhje të jashtëzakonshme.
- 4.9 Kuvendi komunal, përmes shërbimit të tij administrativ dhe teknik, informon anëtarët e komitetet, së paku tri ditë pune, para çdo mbledhje të rregullt.

#### Neni 5

##### Përbajtja e ftesës për mbledhje

5.1 Ftesa apo njoftimi për mbledhje, që u dërgohet antëtarëve të kuvendit komunal, apo anëtarëve të komitetet e tij përfshijnë këto të dhëna:

- a) data e mbledhjes;
- b) koha e mbledhejs;
- c) vendi i mbledhejs;
- d) agenda për mbledhje;
- e) materialet e nevojshme për mbledhje, në gjuhët e kërkuar sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve dhe rregullores së komunës për përdorimin e gjuhëve.
- f) njoftimin nëse mbledhja është e hapur apo jo,
- g) njoftimin se kush e ka thirrë mbledhjen dhe
- h) informacione të tjera relevante

#### Neni 6

##### Mbledhjet e hapura

6.1 Takimet e kuvendit të komunës janë të hapura për opinion.

- 6.2 Kuvendi i komunës, apo komiteti, me votën e shumicës, mund të vendosë për para mbledhejs apo gjatë mbledhjes për të mbajtur mbledhje plotësisht të myllur apo pjesërisht të myllur në rasteët kur:
- a) mendohet se mbajtja e një takimi të hapur mund të shpie deri te një çrrëgullim publik apo dhunë;
  - b) takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione [dhe dokumente], të cilat nuk lejohen të tregohen
  - c) kërcënon të zbulojë informacione të ndjeshme personale apo komerciale; ose

d) informacione lidhur më procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

6.34 Në rastet e tilla, kuvendi i komunës njofton për vendimin e marrë.

6.4 Kryetari, zëvendëskryetari apo i caktuar i tij/saj duhet të ndjekin të gjitha mbledhjet e kuvendit komunal..

#### Neni 7

##### Kuorumi dhe votimi

7.1 Kuorumi për mbëjtjen e mbledhjeve të kuvendit komunal dhe komitetetve të tij është së paku gjysma e anëtarëve të kuvendit komunal.

7.2 Persono që kryeson mbledhjen duhet të verifikojë në fillim të çdo mbledhjeje dhe para se kuvendi të fillojë me votim. Kjo do të përfshihet në procesverbalin e mbledhjes.

7.3 Në mungesë të kuorumit mbledhja shtyhet për një datë të mëvonshme.

7.4 Votimi në kuvend bëhet në njëren prej mënyrave vijuese:

- a) "po" e thjeshtë, apo "jo" me ngritjen e dorës ;
- b) votë të fshehtë; apo
- c) përmes votave të regjistruara.

7.5 Nëse kërkohet vota e regjistruar dhe nëse ka marrë miratimin e shumicës së anëtarëve të kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë, atëherë çdo votë e anëtarëve 'për', "kundër", apo "abstenim" duhet të shënohet me emër dhe të nënshkruhet nga anëtarët të cilët marrin pjesë në mbledhje. Abstenimet numrohen vetëm për përbërjen e kuorumit për mbajtjn e mbeldhjes dhe nuk ndikojnë në rezultatin e votimit.

7.6 Në rast të numrit të barabartë të votave për dhe kundër një propozimi, kryesuesi i kuvendit komunal ka votën vendimtare.

#### Neni 8

##### Agjenda

8.1. Agjenda për mbledhjen e kuvendit komunal propozohet nga kryesuesi.

8.2 Nëse mbledhja thirret me kërkessë të, së paku një, të tretës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit komunal, apo me kërkessë të kryetarit të komunës, e drejta për të thirrë mbledhjen gjithashtu përfshin të drejtën për të përcaktuar agjendën për mbledhjen e thirrur.

8.3 Agjenda për mbledhjen e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet në këtë mbledhje.

8.4. Këshilltari i Kuvendit te Komunës,Kryetari i Komunës apo një i autorizuar i tij si dhe ndonji i autorizuar nga Qeveria,mundë te jadin propozim për plotësimin e Rendit te Ditës.Pika e propozuar hynë si pjesë e Rendit te Ditës nëse e merrë shumicën e votave të Këshilltareve prezent në Seancë.

dëmtojnë privatësinë e personit tjetër, apo të sillen në mënyrë jo-dinjitoze, apo të pengojnë punën e kuvendit komunal.

### Neni 15

#### Masat disciplinore

15.1 Masat vijuese disciplinore aplikohen kundër anëtarit të kuvendit:

- a) Qortim
- b) Vërejtje disciplinore
- c) Ndërprerja e fjalës
- d) Përjashtim nga seanca e kuvendit
- e) Përjashtim nga pjesëmarrja në komitete, komisione dhe nga seanca e ardhme e kuvendit.

15.2 Masa disciplinore në (d dhe e) të nën-nenit 15.1 duhet të miratohen me shumicën e votës së anëtarëve të kuvendit komunal.

### Neni 16

#### Masa disciplinore e qortimit dhe vërejtjes

16.1. Kur një anëtar thotë fjalë ofenduese apo kur sjellja e tij pengon punët apo rregullin e seancës së kuvendit komunal, atij/asaj i jepet vërejtje nga kryesuesi i kuvendit komunal.

16.2. Në rastin kur anëtari, kundër të cilit është shqiptuar masa disciplinore nga paragrafi 1 i këtij neni, dëshiron të ofrojë shpiegime për veprimet apo gjuhën e përdorur, ai/ajo ka të drejtë të flasë në fund të seancës së kuvendit komunal për jo më gjatë se 2 minuta.

16.3 Kur anëtari përsërit shkeljen brenda seancës së njëjtë të kuvendit, atij/asaj i jepet vërejtje disciplinore nga kryesuesi i kuvendit komunal.

Vërejtja e till duhet të përfshihet në procesverbalin e kuvendit komunal.

16.4. Nëse anëtari i tillë, pas shqiptimit të vërejtjes disciplinore vazhdon me sjelljen e till apo fjalët që nuk kanë lidhje me agjendën, atij/asaj i merret fjala.

16.5. Në rast se shprehjet apo ofendimet e bëra nga një anëtar në seancën e kuvendit tërhiqen nga ai/ajo në të njëjtën seancë dhe në rast se anëtari publikisht kërkon falje për sjelljen e tij/saj, kryesuesi i kuvendit komunal anulon masën e shqiptuar disciplinore nga paragrafi 3 i këtij neni.

### Neni 17

#### Masa më të rrepta disciplinore

17.1 Nëse një anëtar vazhdon me sjellje të njëjtë penguese në të njëjtën seancë pasi që t'i jetë tërhequr vërejtja, kryesuesi e largon atë nga seanca e kuvendit për pjesën tjetër të seancës. Në rast se anëtari nuk pajtohet që të lëshojë sallën, kryesuesi i kuvendit ia ndërpert fjalën dhe i jep udhëzime relevante shërbimit të sigurimit në kuvend për të detyruar udhëzimin e tillë.

17.2 Nëse anëtari shkakton dhunë apo provokon ndonjë ndonjë parregullësi në seancën e kuvendit, ai/ajo duhet të largohet nga pjesëmarrja në seancën e ardhshme të kuvendit dhe komiteteve të tij.

17.3 Masa disciplinore e ndalesës nga pjesëmarrja në seancat e kuvendit dhe në komitete duhet të shoqërohet me sanksion finansiar të mospagesës së kompenzimit për atë seancë.

17.4 Masat disciplinore të marra nga kryesuesi i kuvendit komunal nuk paragjykojnë masa të tjera penale të cilat mund të merren kundër ofenduesit, sipas ligjeve në zbatim të Kosovës.

17.5 Nëse ndonjë parregullësi e bënë të pamundur mbajtjen e seancës për atë ditë, kryesuesi e shtyn seancën e kuvendit për një ditë tjetër.

#### Neni 18

##### Ndërprerja e seancës së kuvendit

18.1 Seanca e kuvendit komunal ndërpritet në situatat vijuese:

- a) Për të pasur një pushim gjatë seancës
- b) Kur gjatë seancës numri i anëtarëve të pranishëm është më i ulët se numri që kërohet për kalimin e vendimit
- c) Kur seanca zgjatë gjatë dhe nuk mund të përfundojë në të njëjtën ditë, dhe
- d) Kur çrregullohet renditja e pikave të ditës dhe kryesuesi nuk është në gjendje që seancën ta sjellë në rrjedhë normale me masa disciplinore siç parashihet në nenin 17 të kësaj rregullore të punës.

18.2 Seanca e ndërprerë me të njëjtë rend të ditës duhet të mbahet në ditën vijuese të punës.

#### Neni 19

##### Pyetjet për kryetarin dhe drejtorët dhe përgjigjet gojore

19.1 Çdo anëtar mund t'i parashtrojë pyetje kryetarit apo çdo drejtori komunal.

19.2 Koha për t'iu përgjigjur pyetjeve është me sa vijon:

- a) Përgjigja gojore e kryetarit/drejtoratit nuk mund të jetë më e gjatë se 10 minuta.
- b) Pyetjet që kërkojnë përgjigje me shkrim duhet të dorëzohen së paku pesë (5) ditë pune dhe jo më gjatë se dhjetë (10) ditë pune para seancës së kuvendit. Asnjë person nuk mund të dorëzojë më shumë se dy pyetje për kryetarin/drejtorinë. Pyetjet duhet të ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit përkatës.
- c) Nëse kryesuesi pranon pyetjet, pyetjet duhet të përfshihen në agjendë për seancën vijuese. Nëse pyetjet refuzohen, personi i cili i ka dorëzuar pyetjet duhet të njoftohet me shkrim për refuzimin.
- d) Pyetjeve duhet dhënë përgjigje sipas rradhës së dorëzimit.
- e) Pasi që pyetjeve që janë dorëzuar paraprakisht t'u janë dhënë përgjigjet, kryesuesi mund, nëse lejon koha, që t'i lejojë anëtarit të kuvendit që të parashtrojë pyetje shtesë.
- f) Nëse pyetjes për të cilën kërkohet përgjigje me shkrim, nuk i është dhënë përgjigje brenda kohës së paraparë, anëtar që ka parashtruar pyetjen duhet të njoftohet me shkrim në të njëjtën ditë. Në rastet kur kjo është e pamundur, njoftimi duhet të bëhet jo më gjatë se dy ditë nga data kur pyetjeve normalisht duhet dhënë përgjigje.

## Neni 20

### Çështjet urgjente

20.1 Gjatë çdo seance, çdo grup parlamentar apo anëtar që ka marr pajtimin e kryesuesit mund të propozojë kuvendit komunal që menjëherë të shqyrtojë një çështje urgjente të interesit të posaçëm publik.

20.2 Nëse kryesuesi dhe anëtarët e kuvendit konsiderojnë se çështja duhet të adresohet menjëherë në kuvendin komunal; kryesuesi i lejon grupit apo anëtarit përkatës që ta arsyetojë propozimin e tij në kuvendin komunal dhe pastaj ta votojnë për këtë.

20.3 Nëse kuvendi komunal vendos që ta shqyrtojë çështjen, ai duhet ta bëjë këtë gjatë seancës.

## Neni 21

### Propozimet procedurale

21.1 Në çdo seancë të kuvendit komunal, kryetarët e grupeve parlamentare kanë të drejtë të propozojnë mocionet vijuese procedurale:

- a) ndërprerjen e seancës;
- b) debat në ndonjë pikë të rendit të ditës;
- c) ndryshimin e agjendës apo referimin e çështjes në komitetin apo komisionin relevant;
- d) përfundimin e debatit;
- e) nëse rregullorja e punës është shkelur; apo
- f) kundërshtimin nëse të drejtat e një anëtarit të kuvendi komunal të përcaktuara sipas ligjeve në zbatim dhe kësaj rregulloreje të punës janë shkelur.

21.2 Votim i menjëhershëm duhet të bëhet për pikat a) dhe b) të nenit 21.1 të kesaj rregullore të punës.

21.3 Për pikën c) komiteti apo komisioni duhet të japë arsyen për referencë të tillë. Nëse kryesuesi i kuvendit komunal konsideron se propozimi është në rregull, çështja duhet menjëherë të debatohet në përputhje me procedurat që aplikohen për debate të tillë.

21.4 Pika d) duhet të debatohet menjëherë në përputhje me rregulloren aktuale të punës. Asnjë propozim tjetër nuk duhet të merret parasysh përpos propozimeve nga pika a) dhe b), derisa votimi për këtë propozim të realizohet.

21.5 Për pikën e), kryesuesi i kuvendit duhet të térheq vërejtjen se seanca duhet të mbahet sipas rregullores aktuale të punës.

21.6 Për pikën f), kryesuesi i kuvendit komunal shqyrton propozimin dhe i raporton kuvendit brenda seancës së njëjtë apo në seancën vijuese nëse të drejtat e ndonjë anëtarit janë shkelur apo jo. the chairperson of the municipal assembly reviews the proposal and reports to the.

## Neni 22

### Nënshkrimi i akteve të miratuara nga kuvendi komunal

22.1 Aktet e miratuara nga kuvendi komunal hyjnë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.

22.2 Kryesuesi i kuvendit nënshkruan aktet e miratuara nga kuvendi komunal brenda 48 orëve.

## Neni 23

### Të drejtat dhe obligimet e anëtarëve të kuvendit komunal

23.1 Të gjithë anëtarët e kuvendit komunal kanë të drejta të barabarta për të marrë pjesë në vendimet e kuvendit, pa marrë parasysh etnicitetin e tyre, racën, ngjyrën, gjininë, religionin, përkatësinë politike apo ndonjë bazë tjetër.

23.2 Çdo anëtar duhet të jetë i përkushtuar për të qenë pjesëmarrës aktiv në seancat e kuvendit, në përgatitjen e të gjitha seancave dhe në dhëni e mendimit të tyre për pikat e rendit të ditës. Çdo anëtar duhet të informojë kryesuesi e kuvendit secilën herë që ai apo ajo nuk është në gjendje të marrë pjesë në seancë dhe duhet t'i japë arsyen për këtë të cilat përfshihen në procesverbal.

23.3 Kuvendi duhet të jetë i hapur për sugjerimet që vijnë nga përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë në komunën e Kllokotit-Vërbocit dhe sugjerimet e tillë duhet t'i marr parasysh.

23.4 Kuvendi ndihmon pjesëmarrjen aktive të anëtarëve në nevoja të posaçme dhe ofron të gjitha ndihmat teknike për këtë qëllim.

23.5 Kuvendi do të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të anëtarëve femra dhe do të sigurohet që zëri i tyre të dëgjohet para, gjatë dhe pas mbledhjeve të kuvendit komunal.

23.6 Inkurajimi i pjesëmarrjes aktive në aktivitetet e kuvendit komunal dhe sigurimi i të drejtave të pakicave, grave dhe njerëzve me nevoja të posaçme nuk do të konsiderohet si diskriminim kundër përfaqësuesve të tjera.

## Neni 24

### Konfliktet e interesit

24.1 Çdo anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjëren prej mbledhjeve në të cilën është present. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër. Informacionet duhet të shoqërohen me dëshmi.

24.2 Para mbledhjes së parë të kuvendit të komunës, anëtarët e kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilin e mbanë zyrtari i autorizuar i komunës. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin

24.3 Anëtari i kuvendit të komunës apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.

24.4 Anëtari i kuvendit, komitetit apo komisionit mund të përjashtohet nga procedurat e vendimmarjes sipas paragrafit 1 të këtij neni me tërheqje vullnetare apo me vendimin e shumicës në mbledhjen e kuvendit.

24.5 Nëse egziston konflikt i interesit i cili nuk është vërejtur gjatë procedurës së vendimmarjes, apo nëse anëtari i kuvendit, komitetit apo komisionit nuk ka treguar konfliktet e interesit, vendimi i miratuar anulohet dhe për këtë vendoset përsëri.

#### Neni 25

##### Sekretariati i kuvendit

25.1 Sekretariati i kuvendit komunal është përgjegjës për t'i ofruar mbështetje profesionale, administrative dhe teknike kuvendit dhe anëtarëve të tij.

25.2 Sekretariati i kuvendit caktohet nga administrata komunale.

#### Neni 26

##### Ndryshimi i rregullores së punës së kuvendit

26.1 Kryesuesi i kuvendit komunal mund të propozojë kohë pas kohe kuvendit ndryshimet e rregullores së punës të cilat ai mendon se janë të nevojshme.

26.2 Çdo grup palamentar apo anëtar i kuvendit që ka mbështetjen e së paku një të tretës (1/3) të anëtarëve të kuvendit, mund të dorëzojë propozimin për ndryshimin e kësaj rregulloreje të punës.

26.3 Vendimin për ndryshimin e kësaj rregullore të punës e merr kuvendi me shumicën e votave të anëtarëve.

#### Neni 27

##### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore e punës hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga kryesuesi i kuvendit komunal.

Kllokot-Verboc

